

**RAPORTI I VLERËSIMIT TË KOLEGJIT HEIMERER
I REALIZUAR ME PUNËDHËNËS**

Prishtinë, Dhjetor 2024

Hulumtim mbi nivelin e kënaqshmërisë së punëdhënësve me alumnit dhe praktikantët nga Kolegji Heimerer

Ky hulumtim u realizua me qëllim që të matet niveli i kënaqshmërisë së punëdhënësve për performancën e punës së profesionistëve të diplomuar nga Kolegji Heimerer. Të gjeturat nga ky hulumtim do të kontribuojnë në kuptimin e nivelit të kënaqësisë së punëdhënësve me të diplomuarit e kolegjit dhe identifikimin e aspekteve apo kompetencave që kërkojnë përmirësim.

Në këtë hulumtim morën pjesë 20 profesionistë shëndetësorë të institucioneve të mëposhtme shëndetësore. Mostra e këtij studimi përbëhej nga punëdhënësit e Institucioneve të ndryshme shëndetësore, publike dhe private, me të cilat Kolegji Heimerer ka marrëveshje bashkëpunimi për involvimin e studentëve për fillim punë praktike dhe sipas performancës angazhim të vazhdueshëm si punëmarrës.


Të diplomuarit e punësuar ishin nga drejtimit: Infermieri, Shkenca Diagnostike Laboratorike, Shkenca Diagnostike Terapeutike (Logopedi, Ergoterapi), Psikologji. Në këtë hulumtim morën pjesë gjithsej 20 punëdhënës (15 femra dhe 5 meshkuj. Vlerësimi është realizuar me anë të pyetësorit të bashkangjitur në Google Forms, i përgatitur me të dhëna si: të dhënat personale, (Institucioni, reparti dhe vendi punës, pozita), 8 pyetje të mbyllura në opsione dhe 2 të hapura, të cilat janë shpërndarë përmes email-it.

Rezultatet janë analizuar përmes programit Excel përmes analizës deskriptive/përshkruese.

Tabela 1: Institucionet që i janë përgjigjur këtij pyetësori janë të qendrave sipas emërimit në vijim:

Nr.	Institucioni
1	Spitali i përgjithshëm Ferizaj
2	Shkolla Dardania
3	QKMF Klinë
4	American Hospital Kosova
5	QKMF
6	Laboratori Prolab
7	Diagnostika
8	Kolegji Heimerer
9	Spitali i përgjithshëm Pejë
10	Spital
11	QKMF
12	QKMF Mitrovicë
13	Laboratori HomeLab
14	Laboratori KosLabor
15	Handikos
16	Autizmi
17	Pema
18	SHSKUK
19	Qendra Burimore Përparimi
20	QKMF Mitrovicë

Tabela 2. Struktura e responentëve



Siç shihet në tabelën 2, responentët janë kryesisht në pozita menaxhuese të institucioneve shëndetësore por ka edhe nga pozita tjera. Numri më i lartë i responentëve janë në pozitën e Kryeinfermieres me numër 6 nga totali 20 ose 30%.

Në pyetjen e parë, responentët kanë treguar se a kanë apo jo të punësuar dhe praktikantë në institucionet e tyre shëndetësore. Tabela 3 më poshtë tregon se të gjitha institucionet shëndetësore të përfaqësuara nga responentët kanë të punësuar alumni nga Kolegji Heimerer dhe po ashtu edhe studentë që e kryejnë praktikë.

Tabela 3. Përqindja e alumni dhe praktikantëve në institucione shëndetësore

Pyetjet	Po	Jo
A keni punonjës të cilët kanë mbaruar studimet në Kolegjin Heimerer?	100%	
A keni praktikant të Kolegjit Heimerer, që janë duke e realizuar praktikën në Institucionin tuaj?	100%	

Ndërkaq, më poshtë janë rezultatet nga pyetjet lidhur me nivelin e kënaqshmërisë për performancën e alumni dhe praktikantëve nga Kolegji Heimerer.


Tabela 4. Niveli i kënaqshmërisë së punëdhënësve me alumni dhe praktikantë të KH

Pyetjet	Shumë	Mesatarisht	Pak
A jeni të kënaqur me performancën e tyre në punë?	100%		
A jeni të kënaqur me kompetencat që i kanë arritur ish-studentet e Kolegjit Heimerer që janë punësuar në ndërmarrjen/kliniken tuaj?	92.3%	7.69%	
A ka ngritje të performancës në punë të atyre të cilët kanë qenë të punësuar para se të ishin studentë në Kolegjin Heimerer?	84.6%	15.3%	
Njohuritë që ata kanë marrë në KH a kanë mjaftuar për të qenë të gatshëm për të filluar punën profesionale?	84.6%	15.7%	
Sa janë të përkushtuar në punën që bëjnë?	94.7%	15.3%	
A i përmbahen etikës në vendin e punës?	100%		
Totali	92.70%	13.5%	

Siç shihet te Tabela 4, vlerësimet tregojnë se në përgjithësi punëdhënësit janë shumë të kënaqur me cilësinë e shërbimeve të ofruara nga punonjësit e tyre dhe mesatarja e përgjigjeve me ‘shumë’ në të gjitha pyetjet arrin përqindjen **92.70%**. Ndërkaq mesatarja e përgjigjeve ‘pak’ është **13.5%**. Nuk është dhënë asnjë përgjigje ‘aspak’.

Në pyetjen për vetitë që karakterizojnë alumnit dhe praktikantët nga Kolegji Heimerer, respondentët kanë pasur mundësi të zgjedhin një ose më shumë opsione nga lista e dhënë në tabelën 4.

Tabela. 5 Vetitë që karakterizojnë punonjësit të cilët kanë studiuar në Kolegjin Heimerer.



Siç shihet nga tabela 5, të gjithë respondentët i kanë përzgjedhur të gjitha vetitë e cekura në pyetësor: komunikues, bashkëpunues, fleksibil, të ndershëm, zgjidhin situata emergjente dhe kompetent. Kjo nënkupton se punëdhënësit vlerësojnë se të punësuarit dhe praktikantët nga Kolegji Heimerer i përmbushin dhe i posedojnë të gjitha vlerat e cekura.

Rekomandim

- Përfshirje me e madhe e punëdhënësve në organizime dhe evente të ndryshme.
- Të rishikohet syllabusi me fokus te pjesa praktike.
- Për të rritur numrin e respondentëve që të kemi sa më shumë feedback për performancën e alumni dhe praktikantëve tanë, rekomandojmë që pyetësori për punëdhënësit të dërgohet nga secila përgjegjëse e praktikës drejtpërdrejt tek bashkëpunëtorët e dekanatit, duke pasur parasysh marrëdhëniet e afërta që kanë krijuar. Besojmë se kjo qasje do të ketë një ndikim pozitiv në rritjen e pjesëmarrjes.

Shënim ligjor:

Ky raport është pronë e BPrAL Kolegji Heimerer dhe është përgatitur për qëllime informuese institucionale. Çdo kopjim, shpërndarje, përdorim apo interpretim i përmbajtjes së tij nga persona ose institucione të tjera, jashtë Kolegjit Heimerer, nuk lejohet pa autorizimin e shkruar të Kolegjit. Çdo keqpërdorim apo interpretim i paautorizuar i këtij raporti konsiderohet shkelje e të drejtave institucionale dhe trajtohet në përputhje me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës.

Legal Disclaimer:

This report is the property of BPrAL Heimerer College and has been prepared for institutional informational purposes. Any copying, distribution, use, or interpretation of its content by persons or institutions outside Heimerer College is not permitted without prior written authorization of the College. Any unauthorized use or interpretation of this report shall be considered a violation of the College's institutional rights and will be treated in accordance with the applicable legislation in the Republic of Kosovo.